



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E PROKURIMEVE PUBLIKE

Nr. _____ Prot.

Elbasan, më ____ . ____ . 2024

LËNDA: Dërgim njoftimi i fituesit për botim në Buletinin e Njoftimeve Publike.

AGJENCISË së PROKURIMIT PUBLIK

T I R A N Ë

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT
(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)

Nga: **Bashkia Elbasan** adresa: rruga “Qemal Stafa”, Elbasan.

Drejtuar: “**FLED**” sh.p.k me adresë: Berat Kozare HAVALEHAS Lagjja" Havaleas", rruga Ura e kozares Kuçovë, godinë private 1- katëshe, Nr.307.

Procedura e prokurimit: “**Proçedurë e hapur e thjeshtuar**”.

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-14215-07-25-2024

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “**Ndërtimi i urës mbi përroin Llinxhës në fshatin Jagodinë, Njësia administrative Shushicë dhe Rikonstruksion i urës së përroit ‘Balta e Gaxhjes’ në rrugën e lagjes ‘Katund i Vjetër’, fshati Shushicë, Njësia administrative Shushicë**” me fond limit: **2,005,798** (dymilion e pesëmijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e tetë, vënë në dispozicion nga Buxheti i Bashkisë Elbasan, dhe me afat për kryerjen e punimeve **2 muaj nga data e lidhjes së kontratës.**

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [data] [nr]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. “XHAST” sh.p.k me Nipt: K12512837I

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **1,941,394** (njëmilion e nëntëqind e dyzet e njëmijë e treqind e nëntëdhjetë e katër) **lekë (pa tvsh).**

2. “DENIS CONSTRUCTION” sh.p.k me Nipt: M31420052T

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **1,917,393.96** (një milion e nëntëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e treqind e nëntëdhjetë e tre pikë nëntëdhjetë e gjashtë) **lekë (pa tvsh)**.

3. “FLED” sh.p.k me Nipt: K17621104C

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **1,924,511.52** (një milion e nëntëqind e njëzet e katërmijë e pesëqind e njëmbëdhjetë pikë pesëdhjetë e dy) **lekë (pa tvsh)**.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. “XHAŠT” sh.p.k me Nipt: K12512837I përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1. Keni paraqitur formularin e ofertes duke deklaruar si oferte vleren prej 1,941,394 (një milion e nëntëqind e dyzet e një mijë e treqind e nëntëdhjetë e katër) leke pa tvsh. Nderkohe që referuar preventivit vlera duhet të ishte deklaruar 1,980,221.88 (një milion e nëntëqind e tetëdhjetë mijë e dyqind e njëzet e një pikë tetëdhjetë e tete).

Oferta e operatorit “XHAŠT” sh.p.k me Nipt: K12512837I s’kualifikohet për arsyet e mësipërme.

Në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", neni 92, pika 3, parashikohet se: Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Në VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 82 parashikohet se: Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.

2. “Denis Construction” sh.p.k me Nipt: M31420052T përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1. Në përmbushje të kërkesës së parashikuar në pikën 2.3.1 të kapacitetit teknik, të kriterëve të veçanta për kualifikim, keni paraqitur kontratën me objekt: “Mbrojtja nga lumi Drin në Juban”. Punët e realizuara, objekt i kësaj kontrate nuk janë të ngjashme me punimet objekt i kontratës që prokurohet, kjo edhe sipas kategorisë së punimeve ku ato përfshihen. Konkretisht punimet për mbrojtjen lumore përfshihen në kategorinë NP-9 (Punime dhe mbrojtje lumore sisteme hidraulike dhe bonifikime), ndërsa punimet për ndertimin e urave, objekt prokurimi, përfshihen në kategorinë N.P - 5 (Punime nëntokësore, ura e vepra arti).

Oferta e operatorit “Denis Construction” sh.p.k me Nipt: M31420052T s’kualifikohet për arsyet e mësipërme.

Në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", neni 92, pika 3, parashikohet se: Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Në VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, neni 82 parashikohet se: Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë subjektin: **"FLED" sh.p.k** me adresë: Berat Kozare HAVALEHAS Lagjja" Havaleas", rruga Ura e kozares Kuçovë, godinë private 1- katëshe, Nr.307, se oferta e paraqitur, me një vlerë totale prej **1,924,511.52** (një milion e nëntëqind e njëzet e katërmijë e pesëqind e njëmbëdhjetë pikë pesëdhjetë e dy) **lekë (pa tvsh)** është identifikuar **si oferta e suksesshme.**

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Bashkisë Elbasan**, Drejtoria e Prokurimeve Publike, rruga "Qema Stafa", sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se, nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik".

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraparak)

PO JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) _____

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të procedurës:

PO JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) _____

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
PERSONI I AUTORIZUAR PREJ TIJ
ZV.KRYETARI
Asim Sula**